



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raporti Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Njësia Administrative Zall-Herr”

DOKUMENTI 14

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(TEMATIK)

“NJËSIA ADMINISTRATIVE ZALL-HERR”

Tiranë,2023

📖 PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	3 - 6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3 - 3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve.....	3 - 5
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit.....	5 - 6
II	HYRJA	6 - 9
	a. <i>Objektivat e auditimit.....</i>	
	b. <i>Qëllimi i auditimit.....</i>	
	c. <i>Identifikim i çështjes.....</i>	
	d. <i>Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
	e. <i>Përgjegjësitë e Audituesve.....</i>	
	f. <i>Kriteret e vlerësimit</i>	
	g. <i>Standardet e auditimit.....</i>	
	h. <i>Metodat e auditimi</i>	
	i. <i>Dokumenti i auditimit.....</i>	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.	9 - 26
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	9 - 9
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	9 - 26
2.1	<i>Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.....</i>	9 - 26
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI.....	26 - 28

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim* KLSH), në periudhën nga data 22.9.2022 deri në datën 30.3.2023 realizoi auditimin mbi përputhshmërinë (tematik) në subjektin Njësia Administrative Zall Herr, Bashkia Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 796/1, datë 4.10.2022 (me ndryshime) të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga data 01.01.2019 deri me datë 30.8.2022.

Auditimi u krye me zgjedhje për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje me verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit mbi Përputhshmërinë, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në katër kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1	Në 3 raste, pasuritë e përfiturar me anë të AMTP-së bie mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme dhe mbi pasuri "pyll"), çfarë do të thotë se nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës para vitit 1991, në lidhje me pranimin e kërkesës të znj. H. K, të z. G të G.L, H.S	<i>I mesëm</i>	9 - 26	ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr, të verifikoj AMTP-në, ku sipërfaqja e tokës që kalohet për regjistrim, duhet të përmbushë, njëkohësisht, t'i përkasë një prej zërave të tokës bujqësore me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore. Gjithashtu, para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimin për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991 për vlefshmërinë e

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referencat me Raportin	Rekomandimi
				ngastrës për zërin kadastral të pasurisë
2	Në të gjitha rastet , nga Njësia Administrative Zall-Herr është përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, ku planet e rievimit janë përgatitur dhe hartuar nga specialist/topograf i ZAMIT-së i Njesisë Administrative Zall-Herr dhe jo nga topografi i licencuar, duke mos përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.	<i>I lartë</i>	9 - 26	Njësia Administrative Zall-Herr të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rievimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.
3	Në 3 raste , nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës duke tejkaluar normën për frymë, në kundërshtim me ish-ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr.111/2018 “Për Kadastrën”.	<i>I mesëm</i>	9 - 26	Njësia Administrative Zall-Herr në të gjitha rastet para se të përcjellë dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4	Në 5 raste , nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rievimit të përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.	<i>I mesëm</i>	9 - 26	Specialisti i ZMMT-së, pranë Njesisë Administrative Zall-Herr në të gjitha rastet kur ka kërkesa për saktësim harte duhet ta verifikoj vetë fizikisht bashkë me topografin me licencë ndryshimet e ndodhura, pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera.
5	Në 10 raste , dosjet e kthyer për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë nuk janë plotësuar por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Zall-Herr.	<i>I mesëm</i>	9 - 26	Në gjitha rastet, dosjet e kthyer për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshëm Juridike, Sektorin e AMTP-së Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Zall-Herr duhet ti plotësoj mangësitë e konstatuara dhe ti ridërgojë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.
6	Nga specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr janë pranuar në 3 raste deklaratat e kufitarëve të miratuar vetëm nga Kryetari i Fshatit Priskë e Vogël dhe jo para noterit publik, çfarë e bëjnë këto deklarata absolutisht të pavlefshme.	<i>I mesëm</i>	9 - 26	Njësia Administrative Zall-Herr në të gjitha rastet kur nga personi posedues të tokës bujqësore kërkohet saktësim apo korrigjim pasurie, deklaratat e kufitarëve duhet të konfirmohen para Noterit Publik.
7	Në të gjitha rastet, mbas vitit 2020 edhe	<i>I mesëm</i>	9 - 26	Në të gjitha rastet , Njësia

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referencat me Raportin	Rekomandimi
	pse ligji për procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka ndryshuar, nga Njësia Administrative Zall-Herr janë dërguar dokumentacionet për regjistrim ku si bazë ligjore i referohet Ligjit dhe VKM-ve të shfuqizuar, çfarë do të thotë një përgjegjshmëri nga ana e nëpunësve të administratës, ku njohja me ndryshimet ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve duhet të jetë një element kyç për rritjen e përgjegjshmërisë të administratës të Njesisë Administrative Zall-Herr.			Administrative Zall-Herr, të dërgoj praktikat për regjistrim në DV ASHK Tirana Rurale, në mbështetje të Ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën” Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë dhe VKM-vë që janë në fuqi.

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në subjektin Njësia administrative Zall Herr Bashkia Tiranë, nëpërputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e Raport Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendim nr. 66, datë 23.06.2020 edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit.

Nga auditimi i përputhshmërinë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje meverifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në DV ASHK Tirana Rurale 1, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë *materiale por jo të përhapura*, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një *opinionit të kualifikuar*, paraqitura tek baza për opinion:

Baza për opinionin

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Njesisë Administrative Zall-Herr Bashkia Tiranë, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, ku:

-Në 3 raste pasuritë e përfitur me anë të AMTP-së bie mbi pasuri “pyll”, që do të thotë se nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrëspara vitit 1991.

-Në 10 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

-Në 5 raste, përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje.

-Në 6 raste, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”.

-Në 4 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.

-Në 1 rast, është plotësuar AMTP “Dublikatë” nga Njësia Administrative Zall-Herr dhe e dërguar direk për regjistrim pa u miratuar më parë nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

-Në të gjitha rastet, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Njesisë Administrative Zall-Herr:

Strukturat drejtuese të Njesisë Administrative Zall-Herr, janë përgjegjëse për konfirmimin e AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratimin e plan rilevimit për regjistrimin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e shërbimeve ndaj publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e konfirmimit të AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratim e plan rilevimit për regjistrimin të miratuara nga Njesisë Administrative Zall-Herr, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse regjistrimi i pasurive dhe transaksionet mbi pasuritë, e regjistruara janë kryer, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kërkesat ligjore. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e aktivitetit të institucionit gjatë të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor, nuk lejon vënien në dispozicion të tyre, për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

1. Përshkrim i auditimit.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit Tematik të Auditimit nr.

796/1, datë 4.10.2022 (me ndryshime) të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me afat auditimi nga data 22.9.2022 deri në datën 30.3.2023, në subjektin Njësia Administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë u krye auditimi “Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësisë së lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK”, për periudhën nga 01.01.2019 deri me datë 30.8.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ Përgjegjës Grupi.**
2. **S. S**
3. **P. GJ**

a- Objektivat dhe qëllimi:

Objektivat: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.

Qëllimi: Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

b- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Njësia Administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë dhe përgjegjësitë të tyre, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, përsa i përket procedurës së ndjekur për verifikimin e procedurave të ndjekura për e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK. Në bazë të gjykimit dhe skepticizmit profesional, për qëllimet e auditimit, audituesit kanë bërë vlerësimin, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe janë vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket besueshmërisë, mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë.

Në lidhje me verifikimin e procedurave të mësipërme, nga Grupi i Auditimit u shqyrtuan dokumentacioni tekniko-ligjor, i AMTP-ve, formulari 6, libri kadastral i fshatrave, hartat kadastrale me shk: 1:5000 dhe si dhe harta me shkallë 1:2500, plan rilevimet deklarata noteriale, si dhe korrespondencat shkresore me institucionet përkatëse.

c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit Njësia Administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë janë autoriteti që konfirmojnë për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial. Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, të cilët mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet në lidhje me zbatimin e procedurës për verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin, saktësimin dhe pozicionimin planvendosjeve të tyre për regjistrimin në DV ASHK Rurale 1, në shkelje të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe në referim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”.

d- Përgjegjësitë e Audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim në lidhje me vlerësimin e verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerrja nga evidencat e mbledhura. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të

respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

e- Kriteret e vlerësimit.

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar.
- Ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.
- Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar.
- Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar.
- Ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.
- Ligji nr.20/2020, datë 5.3.2020 “Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore”.
- VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

f- Standardet e auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, e ndryshuar nr. 63, datë 22.06.2020 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

i- Metodatat e auditimit:

Përraritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodatat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

-Metoda "Testim hap pas hapi: Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

-Metoda e ekzaminimit: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të Audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efikasitetin e veprimeve.

-Metoda e ekzaminimit kryq: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve.

-Metoda e inspektimit fizik: Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

-Metoda e intervistimit: Është konsideruar si një nga metodatat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësive të audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të

jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përfitohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

-Metoda e testimit të detajuar: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

j. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Auditimi është në fazën ku nga subjekti audituar (*Njësia administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë*), ka paraqitur kundërshtitë me shkresën nr. 712/1prot, datë 3,5,2023 (*prot KLSH nr. 796/14, date 8,5,2023*), mbi Projekt raport Auditimin, për të cilën grupi i KLSH pasi analizojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm, mori në konaidetatë rastet të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion. Ndërsa rastet e tjera të cilat nuk kishin argumentin e mjaftueshëm ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi (Tematik), i cili i përcillet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Zall-Herr Bashkia Tiranë për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtëjshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore”, i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit nr. 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Pika 2.1. Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Komuna Zall-Herr sot Njësia Administrative Zall-Herr, Bashkia Tiranë ka ndarë tokë sipas ligjit nr. 7501 “Për Tokën” për familje të cilët kanë qenë banorë të ish NB dhe Kooperativave bujqësore me datë 19.07.1991 për 10 fshatra të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Fshati	Sip tokës Gjithsej (ha)	Tokë e ndarë në pronësi sipas formularit 6
1	Zall-Herr	398.6	328.5227
2	Herraj	121.6	66.475
3	Pinar	141	735.7755
4	Prisk e Vogël	136.4	54.6692
5	Çekrezë	849.5	256.4625
6	Kallmet	0	71.98
7	Rradhesh	0	29.958
8	Dritas	1074	231.401
9	Qinam	0	187.5851
10	Kasallë	0	81.6236
	Totali	2721.1	2044.4526

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Zall-Herr

Shënim: Fshati Qinam dhe Kasallë kanë marrë tokë në fondin e tokës Dritas dhe fshati Kallmet dhe Rradhesh kanë marrë tokë në fondin e tokës të fshatit Çekrezë.

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Zall-Herr për konfirmimin e AMTP dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore” (i ndryshuar), në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, rezultoi si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi, sipas kërkesave të subjekteve dhe individëve nga Njësia Administrative Zall-Herr janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **31 praktika** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Nr. Rendor	Nr. Prot., datë nisur nga Njësia Administrative Zall-Herr Nr. hyrës në Njësinë Adm. Zall-Herr i shkresës përcjellëse nga Bashkia Tiranë në lidhje me praktikën e përcjellë për në ASHK.	Nr. prot të shkresës përcjellëse që ka kaluar praktika nga Bashkia Tiranë për në ASHK.	Emri i banorit.
1	Nr.819/1 datë 18.07.2019/ Nr.819/2 datë 25.07.2019	Nr.28860/1 datë 24.07.2019	SH. H
2	Nr.2078/1 datë 07.01.2019/ Nr.315 datë 20.02.2019	Nr.315 datë 20.02.2019	P. L

Nr. Rendor	Nr. Prot., datë nisur nga Njësia Administrative Zall-Herr Nr. hyrës në Njësinë Adm. Zall-Herr i shkresës përcjellëse nga Bashkia Tiranë në lidhje me praktikën e përcjellë për në ASHK.	Nr. prot të shkresës përcjellëse që ka kaluar praktika nga Bashkia Tiranë për në ASHK.	Emri i banorit.
3	Nr.162/1 datë 07.03.2018/ Nr.1162/2 datë 28.03.2019	Nr.11318/1 datë 27.03.2019	A. K
4	Nr.799/1 datë 29.05.2019/ Nr.799/4 datë 17.07.2019	Nr.23009/3 datë 16.07.2019	A.V
5	Nr.1031/1 datë 18.07.2019/ Nr.1031/2 datë 30.08.2019	Nr.28858/1 datë 29.08.2019	M.L
6	Nr.809/1 datë 29.05.2019/ Nr.1370 datë 12.09.2019	Nr.23008/3 datë 29.08.2019	F.M
7	Nr.1119 datë 29.07.2019/ Nr.1119/2 datë 05.11.2019	Nr.30030/1 datë 01.11.2019	L.V
8	Nr.794/1 datë 18.07.2019/ Nr.1787 datë 08.10.2019	Nr.28903/3 datë 07.10.2019	SH.N
9	Nr.820/1 datë 29.05.2019/ Nr.2026 datë 08.11.2019	Nr.23007/3 datë 06.11.2019	S.XH
10	Nr.1337/1 datë 19.09.2019/ Nr.1959 datë 05.11.2019	Nr.35208/1 datë 01.11.2019	G.V
11	Nr.802/1 datë 22.08.2019/ Nr.802/2 datë 06.11.2019	Nr.32932/1 datë 04.11.2019	A.S
12	Nr.1357/1 datë 19.09.2019/ Nr.1357/4 datë 18.11.2019	Nr.36298/3 datë 15.11.2019	S.XH
13	Nr.1623/1 datë 20.11.2019/ Nr.591 datë 03.03.2020	Nr.1443/1 datë 28.02.2020	A.XH
14	Nr.916/1 datë 22.08.2019/ Nr.2025 datë 08.11.2019	Nr.32955/2 datë 06.11.2019	H.M
15	Nr.1151/1 datë 02.09.2019/ Nr.2880 datë 31.12.2019	Nr.32955/1 datë 27.12.2019	B.H
16	Nr.2868/1 datë 24.12.2020/ Nr.506 datë 12.03.2021	Nr.95/3 datë 11.03.2021	M.V
17	Nr.608/1 datë 24.12.2020/ Nr.307 datë 19.02.2021	Nr.101/1 datë 16.02.2021	A.F
18	Nr. 944/1 datë 08.06.2020/ Nr. 2111 datë 19.10.2020	Nr.19477/5 datë 14.10.2020	R.D
19	Nr.2091 datë 15.10.2020/ Nr. 2485 datë 06.11.2020	Nr.35544/1 datë 04.11.2020	SH.L
20	Nr.2351 datë 19.11.2020/ Nr. 2817 datë 10.12.2020	Nr.42171/1 datë 07.12.2020	H.F
21	Nr. 2774/1 datë 14.12.2020/ Nr.284 datë 16.02.2021	Nr. 5818/1 datë 15.02.2021	S.L
22	Nr.2011/1 datë 22.10.2020/ Nr. 2 datë 05.01.2021	Nr.38955/3 datë 30.12.2020	XH.G
23	Nr. 2979/1 datë 24.12.2020/ Nr. 308 datë 19.02.2021	Nr. 308 datë 19.02.2021	I. Q
24	Nr.2243/1 datë 02.11.2020/ Nr.305 datë 19.02.2021	Nr. 7717 datë 16.02.2021	A.G
25	Nr. 2154 datë 19.11.2020/ Nr. 306 datë 19.02.2021	Nr. 7716 datë 16.02.2021	A.H
26	Nr.2189/1 datë 14.12.2020/ Nr.315 datë 22.02.2021	Nr.7720 datë 16.02.2021	L. H
27	Nr. 2799/1 datë 17.12.2020/ Nr.304 datë 19.2.2021	Nr.7719 datë 16.02.2021	H. R
28	Nr.2428/1 datë 28.05.2020/ Nr.1445 datë 04.08.2020	Nr.1445 datë 04.08.2020	H. H
29	Nr.2861/1 datë 24.12.2020/ Nr.147 datë 26.01.2021	Nr.102/1 datë 25.01.2021	M. H
30	Nr.2363/1 datë 28.01.2021/ Nr.303 datë 19.02.2021	Nr.5836 datë 16.02.2021	XH. D
31	Nr.2226/1 Prot, datë 01.02.2021/ Nr.309 datë 19.02.2021	Nr.6471/1 datë 16.02.2021	H. S

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se për 31 dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë nga Njësia Administrative Zall-Herr dhe të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, kjo e fundit me shkresë ka bërë njoftim Njesisë Administrative Zall-Herr për dosjet e plotësuara të cilat janë nisur drejt ASHK për regjistrim.

Nga të dhënat e rezulton se Njësia Administrative Zall-Herr për periudhën objekt auditimi ka dërguar dosje të plotësuara për regjistrim drejt ASHK në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësiti Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore”, për **20 praktika** si më poshtë:

Nr. Rendor	Nr. Prot., datë nisur nga Njësia Administrative Zall-Herr Nr. hyrës në Njësinë Adm. Zall-Herr i shkresës përcjellëse në lidhje me praktikën e përcjellë për në ASHK.	Emri i banorit.	Fshati/ Zona kadastra-le	Formulari 6	Sip. Sipas AMTP-së.
1	Nr. 798 datë 20.04.2021	N. K	Cerkezë 1377	Nr. 252 faqe 36 Sip.5600m	10000
2	Nr.804 datë 21.04.2021	K. G	Qinam 3116	Nr.11 faqe 2 Sip.11350m	11000
3	Nr.613 datë 29.03.2021	S. SH	Priskë e vogël3052	Nr.29 faqe 7 Sip.5900m	5900
4	Nr.853 datë 28.04.2021	F. L	Cerkezë 1377	Nr. 47 faqe 7. Sip.18000m	7100

Nr. Rend or	Nr. Prot., datë nisur nga Njësia Administrative Zall-Herr Nr. hyrës në Njësinë Adm. Zall-Herr i shkresës përcjellëse në lidhje me praktikën e përcjellë për në ASHK.	Emri i banorit.	Fshati/ Zona kadastra-le	Formulari 6	Sip. Sipas AMTP-së.
5	Nr.825 datë 23.04.2021	G. L	Pinar 2961	Nr.60faqe 13. Sip.28900m	28100
6	Nr.965 datë 20.05.2021	B. K	Zall-Herr 3878	Nr.79faqe 16. Sip.18460m	18460
7	Nr.896 datë 06.05.2021	H. Q	Priskë e vogël 3052	Nr. 4 faqe 10. Sip.10900m	7875
8	Nr.2607 datë 11.11.2020	G. L	Dritas 1549	Nuk figuron.	9800
9	Nr.586 datë 22.03.2021	K. XH	Qinam 3116	Nr.18faqe 3. Sip.11570m	11220
10	Nr.631 datë 30.03.2021	B. F	Kallmet 2052	Nr.45faqe 12. Sip.18600m	18600
11	Nr.612 datë 29.03.2021	SH. V	Dritas 1549	Nr.19faqe 3. Sip.9000m	9000
12	Nr.633 datë 30.03.2021	R. A	Zall-Herr 3878	Nr.143 faqe 30. Sip.26600m	26600
13	Nr.674 datë 06.04.2021	Z. B	Pinar 2961	Nr.14 faqe 3. Sip.8568m	8568
14	Nr.719 datë 09.04.2021	XH. U	Qinam 3116	Nr.121 faqe 18. Sip.12310m	11960
15	Nr.734 datë 12.04.2021	XH. H	Dritas 1549	Nr.174 faqe 25. Sip.9000m	8000
16	Nr.765 datë 16.04.2021	Z. C	Priskë e vogël 3052	Nr.19faqe 3. Sip.8000m	17787
17	Nr.779 datë 16.04.2021	M. T	Dritas 1549	Nr. 265faqe 34. Sip 10000m	10000
18	Nr.338 datë 22.02.2021	H. K	Dritas 1549	Nuk figuron.	13300
19	Nr.632 datë 30.03.2021	R. C	Zall-Herr 3878	Nr. 74 faqe 15. Sip.16160m	16160
20	Nr.757 datë 14.04.2021	S. L	Priskë e vogël 3052	Nuk figuron	6110

Burimi i të dhënave NJ/Administrative Zall-Herr.

Titulli gjetjes: *Problematikat e konstatuara në dërgimin e AMTP për regjistrim në ASHK.*

Situata

Nga të dhënat e rezultojnë se Njësia Administrative Zall-Herr për periudhën objekt auditimi, ka dërguar AMTP për regjistrim drejt ASHK-së, duke mos qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore, me si më poshtë:-

-Në 3 raste, pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bie **mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme dhe mbi pasuri “pyll”)**, çfarë do të thotë se nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrëspara vitit 1991.

Në të gjitha rastet, planet e rilevimit janë përgatitur dhe hartuar nga specialist/topograf i ZAMIT-së i Njesisë Administrative Zall-Herr dhe jo nga topografi i licencuar.

-Në 4 raste, nga Njësia Administrative Zall-Herr, janë përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë, Akte të Marrjes Tokës në Përdorim dhe jo në Pronësi.

-Në 3 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë.

-Në 6 raste, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara

në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

-Në 5 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.

-Në 10 raste, dosjet e kthyerat për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë nuk janë plotësuar por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Zall-Herr.

Në të gjitha rastet, mbas vitit 2020 edhe pse ligji për procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka ndryshuar, nga Njësia Administrative Zall-Herr janë dërguar dokumentacionet për regjistrim ku si bazë ligjore i referohet Ligjit dhe VKM-ve të shfuqizuar, çfarë do të thotë një papërgjegjshmëri nga ana e nëpunësve të administratës, ku njohja me ndryshimet ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve duhet të jetë një element kyç për rritjen e përgjegjshmërisë të administratës të Njesisë Administrative Zall-Herr.

Kriteri

Në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 “Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësia Administrative nën administrativin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore”; me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”; me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, i ndryshuar; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar me ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr. 39203/1, datë 17.10.2019 “Për një shtesë në Urdhrin nr. 26474/1, datë 02.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë “Për delegim kompetencave nga

Ndikimi/efektiviteti	Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë”.
Shkaku	Parregullsia në dokumentacionin shoqërues të AMTP për regjistrim në kundërshtim me akte ligjore.
Rëndësia	Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.
Për këtë rekomandojmë	I lartë Njësia Administrative Zall-Herr Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 1, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas rasteve ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. XH. XH** me detyrë, ish-Përgjegjës i ZAMIT-së.
2. **Z. F. K** me detyrë, ish-Specialist i ZAMIT-së.
3. **Z. F. L** me detyrë, Specialist/topograf i ZAMIT-së.
4. **Z. E. T** me detyrë, ish-Kryetari i Fshatit Dritas.
5. **Z. N. V** me detyrë, Kryetari i Fshatit Dritas.

Praktikat me parregullsinë dokumentacion.

1. Praktika e kryefamiljarit S.R. Xh.

Me shkresën nr. 1357/1 prot., datë 19.09.2019 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr. Akti dhe pa datë, fotokopje e arshivuara në ASHK, Fshati Qinam për S. XH, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjellë në emër të S. XH, ka rezultuar se AMTP-ja është me korrigjim tek fjalët në “Përdorim” por pa nënshkrimin ose vulën zyrtare të ish-Komunës.

Nga ana Bashkisë Tiranë është kthyer dokumentacioni i Njesisë Administrative Zall-Herr me shkresën nr.36298/1 prot., datë 03.10.2019 duke kërkuar depozitimim e deklarimit të anëtarëve të ish-komisionit të ndarjes së tokës në fshatë ose proces verbal të mbajtur nga ky komision

Nga Njësia Administrative Zall-Herr me shkresën nr.1357/3 prot., datë 04.10.2019 është dhënë si argument se akti nga “përdorim” është fshirë më vizë dhe është shkruar me shkrim dore në “pronësi” e gjithashtu është dërguar kopje e formularit nr.6.

Me shkresën nr.7647/1 prot., datë 21.01.2020 nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1 është kthyer përgjigje Njesisë Administrative Zall-Herr dhe për dijeni qytetarit S. XH për plotësim dokumentacioni, e cila ka konstatuar se AMTP-ja është me korrigjim tek fjalët në “Përdorim” por pa nënshkrimin ose vulën zyrtare të ish-Komunës.

Njësia Administrative Zall-Herr, me shkresën nr. 143/1 prot., datë 27.01.2020 i kthen përgjigje DV ASHK Tirana Rurale 1, se mbi AMTP-në në emër të S. XH, banor i fshatit Qinam, Njësia Administrative Zall-Herr, subjekti i trajtuar me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 dhe në bazë të VKM-së nr.452, datë 18.10.1992 “Për Ristrukturimin e ndërmarrjeve Bujqësore” i cili është trajtuar nga ish-komisioni i Ndarjes së Tokës i Fshatit Qinam sipas AMTP-së pa i shënuar nr. Akti, pa datë lëshimi me një sipërfaqe të përgjithshme

16850 m², akti i cili fillimisht në bazë të VKM-së të lartpërmendur është lëshuar në “përdorim” por më vonë më daljen e ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar ish-komisioni i Ndarjes së Tokës për mungesë aktesh (AMTP në pronësi) ka vepruar në këtë mënyrë, duke ndryshuar titullin nga “përdorim” në “pronësi”, ndryshim i pa vulosur i cili është lënë gabimisht pa plotësuar nga ish-Komisioni i Ndarjes së Tokës i Fshatit Qinam, për arsye subjektive. Ky akt është i nënshkruar nga Kryetari dhe përfaqësuesi i Rrethit dhe në listën e Qarkut gjendet me vula.

Në dosje janë të administruar planrilevimet për tre ngastrat e pasqyruara ne AMTP ku sipas ngastrës nr. 1 me sipërfaqe 2600 m² pozicionohet në pasurinë nr.112/23, vol 11, faqe 96, K. 1549, arë me siperfaqe 3000 m² “shtet” dhe pasuria nr.112/4, vol 8, faqe 226. K..1549 “arë” me sipërfaqe 3000 m² në pronësi të B. XH.

Në ngastrën nr.2 sipas AMTP ka një sipërfaqe prej 6500 m² “arë”, ndërsa sipas planit të rilevimit sipërfaqja është 6000 m².

Ngastra nr.5 “arë” me sipërfaqe 400 m², pozicionohet në pasurinë nr.185/15, vol 5, faqe 213, K. 3116 “pemtore” me sipërfaqe 10000 m² “shtet”.

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar AMTP-ja për regjistrim, pa nr. Akti dhe pa datë, fotokopje e arshivuara në ASHK, Fshati Qinam për S. XH, pa pasur më parë një deklaratë nga anëtarët e komisionit të ndarjes së tokës në fshatë ose një procesverbal të mbajtur nga ky komision.

-Mungon deklara noteriale për heqjen dorë nga sipërfaqe prej 500 m² për ngastrën nr.2.

-Tre deklaratat e kufitarëve janë miratuar vetëm nga Kryetari i Fshatit Fshati Qinam dhe jo para noterit publik, çfarë e bëjnë këto deklaratat absolutisht të pavlefshme.

2- Praktika e kryefamiljarit M. L

Me shkresën nr.103/1 prot., datë 28.08.2019 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në me nr. 36 akti, datë 10.8.1993 , për **M. L**, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjellë në emër të M. L, ka rezultuar se AMTP-ja është me korrigjim tek fjalët në “Përdorim” por pa nënshkrimin ose vulën zyrtare të ish-Komunës. Është dërgimi i AMTP për regjistrim pa bërë më parë kalimin në pronësi, pa shpërblim, për tokën bujqësore nga përdorim në pronësi, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar AMTP-ja për regjistrim, pa nr.akti dhe pa datë, fotokopje e arshivuar në ASHK, për z. M. L, pa pasur më parë një deklaratë nga anëtarët e komisionit të ndarjes së tokës në fshatë ose një procesverbal të mbajtur nga ky komision në lidhje me korrigjimin e AMTP-së.

3. Praktika e kryefamiljarit S. XH

Me shkresën nr.820/1 prot., datë 22.08.2019 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr. Akti, datë 11.9.1993 , për **S. XH**, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjellë në emër të S. XH ka rezultuar se AMTP-ja është me korrigjim tek fjalët në “Përdorim” por pa nënshkrimin ose vulën zyrtare të ish-Komunës.

Është dërgimi i AMTP për regjistrim pa bërë më parë kalimin në pronësi, pa shpërblim, për tokën bujqësore nga përdorim në pronësi, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar dhe me

ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar AMTP-ja për regjistrim, pa nr. Akti dhe pa datë, fotokopje e arshivuar në ASHK, për z. S. XH, pa pasur më parë një deklaratë nga anëtarët e komisionit të ndarjes së tokës në fshatë ose një procesverbal të mbajtur nga ky komision në lidhje me korrigjimin e AMTP-së.

4. Praktika e kryefamiljarit G. V

Me shkresën nr.1337/1 prot., datë 19.09.2019 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 219 Akti, datë 10.7.1993 , për **G. V**, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjellë në emër të G. V ka rezultuar se AMTP-ja është me korrigjim tek fjalët në “Përdorim” por pa nënshkrimin ose vulën zyrtare të ish-Komunës.

Dërgimi i AMTP për regjistrim pa bërë më parë kalimin në pronësi, pa shpërblim, për tokën bujqësore nga përdorim në pronësi, janë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore”, i ndryshuar dhe me ligjin nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”.

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar AMTP-ja për regjistrim, pa nr. Akti dhe pa datë, fotokopje e arshivuar në ASHK, për z. G. V pa pasur më parë një deklaratë nga anëtarët e komisionit të ndarjes së tokës në fshatë ose një procesverbal të mbajtur nga ky komision në lidhje me korrigjimin e AMTP-së.

5. Praktika e kryefamiljarit SH. L

Me shkresën nr.2091 prot., datë 15.10.2020 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 85 akti datë 25.6.1992, për **SH. L** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimi të NJA-VE dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të NJA-VE dhe të AMTP-ve, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të SH. L rezulton se AMTP-ja është e pa arkivuar ne ASHK. Dokumentacioni bashkëlidhur dosjes nuk është provues për AMTP-në me nr. Akti 85, datë 25.6.1992, për subjektin SH. L.

Konkluzion: Referuar sipërfaqes së përgjithshme të kësaj AMTP-je e cila është 28420 m² dhe gjendjes familjare 01.08.1991. ky subjekt ka tejkalim të normës për frymë, në këto kushte AMTP-ja me nr. Akti 85, datë 25.6.1992 është pjesërisht e pavlefshme.

6. Praktika e kryefamiljarit M. V

Me shkresën nr.125/1 prot., datë 01.03.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 14 akti, datë 10.6.1992, për **M. V**, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimi të NJA-VE dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të NJA-VE dhe të AMTP-ve, Bashkia Tiranë, për regjistrimin pranë ASHK të pasurisë me nr.139/9, K.2961, sipërfaqe 2600 m² rreshti III.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të M. V rezulton se subjekti është pajisur me 2 (dy) AMTP. Me AMTP-në me nr. 14 akti dhe datë 10.6.1992, pa sipërfaqe gjithsej të shënuar por me shumatore 17660 m² në emër M. V dhe me AMTP-në pa nr. Akti, datë 20.04.1996, sipërfaqe gjithsej 12000 m², në emër të M. V.

Bazuar në çertifikatën e gjendjes civile të përfituesit (kryefamiljarit) datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992, është me 4 (katër) anëtarë, ndërsa norma për frymë për Fshatin Pinar nuk ka informacion.

Konkluzion: Është pranuar kërkesa nga Njësia Administrative Zall-Herr për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të M. V, bazuar në 2 (dy) AMTP ku rezulton se ka përfitur një sipërfaqe tokën bujqësore më shumë se sa ka qenë norma për frymë në Fshatin Pinar.

7. Praktika e kryefamiljarit B. H

Me shkresën nr.1151/1 prot., datë 20.11.2019 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 139 akti, datë 27.2.2001, për **B. H**, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të B. H rezulton se Bashkia Tiranë ka kërkuar informacion nga DAMT në lidhje me llojin e pasurisë, nga ku rezulton se pasuria nr.245/1, me sipërfaqe 700 m², K. 1377, mbivendoset mbi parcelën me nr. 243, e cila figuron me zërin Kadastral “P,F” dhe “Truall”, gjendja deri në datë 01.08.1991.

Konkluzion: Nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa e Z. B. H si dhe është miratuar plan-rilevimi për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtetësinë ellojit të pasurisë, nëse parcela e renditur në AMTP me nr.245/1, me sipërfaqe 700 m², Z.K. 1377, mbi pasurinë nr.143 është në zërit kadastral P.F apo tokë “arë”.

8. Praktika e kryefamiljarit H. S

Me shkresën nr.2226/1 prot., datë 01.02.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 58 akti, datë 18.6.1992, për z. H. S, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimi të NJA-VE dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të NJA-VE dhe të AMTP-ve, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i relacionit shpjegues të Njesisë Administrative Zall-Herr i përcjell në emër të z. H. S, rezulton se nuk përcaktohet nëse familja bujqësore është furnizuar me tokë si pjesë e ish-kooperativës apo e ish-ndërmarrjes bujqësore.

Në relacionin shpjegues datë 01.02.2021 nuk sqaron se, pasuria 83/2, prek pasurinë nr.189/2 pasuri e fituar me anë të AMTP-në nr. 58 akti, datë 18.6.1992.

Nga ana e specialistit të ZAMIT-së Njësia Administrative Zall-Herr nuk është verifikuar në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor nëse është “pyll” apo “arë”, për të vlerësuar vlefshmërinë e plotësimin të AMTP me nr. 58 akti, datë 18.6.1992 lëshuar nga ish-komisioni i ndarjes së tokës.

Konkluzion: -Nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa e Z. H. S, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së me nr.Akti 58 akti, datë 18.6.1992) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtetësinë ellojit të pasurisë.
-Nga Njësia Administrative Zall-Herr është miratuar plan-rilevimi për pasurinë nr. 83/2, datë 04.11.2020 duke prekur mbi pasurinë “Pyll” ku me shkresën nr.2226/1 prot., datë 01.02.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar për regjistrim pasuria me sipërfaqe 7800 m² në emër të Z. H. S.

Plani i rilevimit i hartuar me datë 04.11.2020 nga topografi i NJA Zall-Herr, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”..

9. Praktika e kryefamiljarit H. F

Me shkresën nr.2351/1 prot., datë 19.11.2020 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.35 akti datë 19.9.1993, për **H. F**, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshëm e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimi të NJA-VE dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të NJA-VE dhe të AMTP-ve, Bashkia Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se AMTP-ja me nr.35 akti, datë 19.9.1993 e nxjerrë nga arkiva e ASHK-së është me korrigjime.

Në shkresën e Njësies Administrative Zall-Herr, drejtuar Bashkisë Tiranë mungon formulari 6 për të provuar 8 pasuritë e fituara me AMTP.

Konkluzion: Plan-rilevimit e përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr, nuk përmbushin standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale”.

10. Praktika e kryefamiljarit K. G

Me shkresën nr.824 prot., datë 21.04.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në e korrigjuar nga përdorim në pronësi pa nr. Akti datë 11.7.1993, për **K. G** drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje ndodhet e administruar edhe Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr ku sqaron se, **K. G** ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën nr.1,2,3,4,5 ju sqarojmë se: Parcela 1 me emërtimin popullor “Kodra e grifshet 178,179” me sipërfaqe të përgjithshme 1600 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.172/2 me sipërfaqe 1200 m² dhe nr. 177/10 me sipërfaqe 400 m².

Parcela nr.2 dhe 4 me emërtimin popullor “Gazhel” me sipërfaqe të përgjithshme 3600 m² dhe 2900 m² sipërfaqe të përgjithshme 6500 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.123 me sipërfaqe 4200 m² Per sipërfaqen e munguar po ju dërgojmë deklaratën noteriale pe përfaqësues **K. G**.

Pasuria nr.5 me emërtimin popullor “Zavakaj” me sipërfaqe të përgjithshme 2900 m², e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr. 258 me sipërfaqe 500 m².

Nga verifikimi i AMTP-së i plotësuar nga ish-komisioni i tokës në Fshatit Qinam e korrigjuar nga përdorim në pronësi pa nr. Akti datë 11.7.1993, në emër të kryefamiljarit **K. G** rezulton se 3 pasuritë e renditura me numër rendor:

Nr. 3, me emërtimin popullor “Orinam” me sipërfaqe 350 m² në llojin e pasurisë “truall”.

Nr. 4, me emërtimin popullor “Gazhel” me nr. pasurie 123/3 me sipërfaqe të 2900 m², në llojin e pasurisë “arë”.

Nr. 5 me emërtimin popullor “Zavolaj” me nr. Pasurie 187/1, me sipërfaqe të përgjithshme 2900 m² dyshohet se janë plotësuar në shtesë të AMTP-së, (është ë dyshuar për fallcifikim). Në lidhje me statusin juridik të pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, është kthyer përgjigje në lidhje me:

Pasurinë nr. 123/8 vol 1, faqe 166 me sip. 4780 m² në llojin e pasurisë “arë”, në emër “shtet”.

Pasurinë nr. 177/2 vol 3, faqe 86 me sip. 3500 m² në llojin e pasurisë “arë”, në emër “shtet”.

Pasurinë nr. 177/10 vol 3, faqe 96 me sip. 135 m² në llojin e pasurisë “pemtore”, në emër “shtet”.

Plan-rilevimit datë 04.04.2021 që ka lidhje me pasurinë nr.123 K. 3116 e përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr, me emërtimin popullor “Gazhel” rezulton me një sipërfaqe 4200 m², nga 3600 m² që rezulton në AMTP, sipërfaqja prej 400 m² bie krejtësisht mbi pasuri të tretëve.

Plan-rilevimit datë 04.04.2021 që ka lidhje me emërtimin popullor Parcela 1 me emërtimin popullor “Kodra e grifshet” e përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr, është e ndarë në dy pasuri me nr.172/2 me siperfaqe 1200 m² dhe nr. 177/10 me sipërfaqe 400 m².

Pasuria nr.177/10 me sipërfaqe 400 m² nuk përputhet me pasurinë me sip. 135 m² e regjistrua në DV ASHK Tirana Rurale 1, për faktin se kjo pasuri rezulton me e vogël në sipërfaqe dhe se lloji i pasurisë është “pemtore” dhe jo “arë”.

Konkluzion: -Plan-rilevimet e hartuara nga subjekti privat i licensuar dhe të miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr në të cilën është pozicionuar pasuria sipas gjendjes faktike, nuk përputhen me hartën kadastrale që punon DV ASHK Tirana Rurale 1, që do të thotë se pasuria sipas planit të gjendjes faktike ka konfiguracion e pozicionim të ndryshëm nga paraqitja hartografike e bërë në hartën e punës dhe ky ndryshim konfiguracioni e pozicioni ka krijuar mbivendosje me pasuri të tretëve.

-Në dosje mungon e administruar deklarata noteriale me kufitaret.

11. Praktika e kryefamiljarit G. L

Me shkresën nr.825prot., datë 23.04.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 23 akti datë 17.6.1992, për G. L drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje është e administruar:

-Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr, sqaron se K. G ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën nr.,2,3,4,5 ju sqarojmë se: Parcela 2 me emërtimin popullor “Nr.2” me sipërfaqe të përgjithshme 800 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.120/2 me siperfaqe 800 m².

Parcela 3 me emërtimin popullor “Nr.125/2” me sipërfaqe të përgjithshme 9000 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.125/2 me sipërfaqe 9000 m².

Parcela 4 me emërtimin popullor “Nr.127” me sipërfaqe të përgjithshme 7500 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.180/2 me sipërfaqe 7500 m².

Parcela 5 me emërtimin popullor “Nr.138/12” me sipërfaqe të përgjithshme 3000 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.138/12 me sipërfaqe 3000 m².

-Shkresa nr.363 prot., datë 19.04.2021, kthim përgjigje DV ASHK Tirana Rurale 1, ku citohet së nga kërkimi në sistemin dixhital nuk u gjet AMTP-ja në emër të G. L, në K. 2961, Fshati Pinar, Njësia Administrative Zall-Herr.

Konkluzion: -Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohet të regjistrohen.

-Mungon e administruar deklarata noteriale me kufitare bashkëlidhur planrilevimeve të përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr,

-Plan rilevimi përgatitur nga Topografi me licencë nuk përputhet me kufitare e shënuar në AMTP për pasurinë me nr.125/2 me sipërfaqe 9000 m², në perendim në HRT është rrugë ndërsa në AMTP është kufitare S. XH.

12. Praktika e kryefamiljarit S. SH

Me shkresën nr.613 prot., datë 29.03.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.29 akti, pa datë, për S. SH drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje është e administruar:

-Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr, ku sqaron se K. G ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën nr.,1, 3 ju sqarojmë se:

Parcela 1 me emërtimin popullor “Rreth Shtëpisë” me sipërfaqe të përgjithshme 2700 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.73/2 me sipërfaqe 2700 m² dhe nr.77/1 me sipërfaqe 300 m².

Parcela 2 me emërtimin popullor “Rreth Shijon” me sipërfaqe të përgjithshme 2800 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.134/1 me sipërfaqe 2800 m².

-Shkresa nr.207 prot., datë 05.03.2021, kthim përgjigje DV ASHK Tirana Rurale 1, ku citohet së nga kërkimi në sistemin dixhital nuk u gjet AMTP-ja në emër të S. SH, në K. 3052, Fshati Priskë e Vogël, Njësia Administrative Zall-Herr.

Konkluzion: -Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Tre deklaratat e kufitarëve janë miratuar vetëm nga Kryetari i Fshatit Priskë e Vogël dhe jo para noterit publik, çfarë e bëjnë këto deklarata absolutisht të pavlefshme.

-Mungojnë dy planrilevimet e përgatitur nga Topografi me licencë dhe të miratuara nga Njësia Administrative Zall-Herr, pasurive me nr.73/2 me sipërfaqe 2700 m² dhe nr.77/1 me sipërfaqe 300 m² dhe pasurinë me nr.134/1 me sipërfaqe 2800 m².

13. Praktika e kryefamiljarit N. K

Me shkresën nr. 798 prot., datë 20.04.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.29 akti, pa datë, për N. K drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje është e administruar:

-Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr, ku sqaron se N. K ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën nr.1, ju sqarojmë se:

Parcela 1 me emërtimin popullor “Teporja e Korrve” me sipërfaqe të përgjithshme 4800 m² ku banori është pajisur me certifikatë pronësie për sipërfaqen prej 2400 m² dhe kërkon të pajisjen

për pjesën e mbetur e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurive nr.418 me sipërfaqe 2400 m².

-Shkresa pa nr. prot., datë 05.03.2021, kthim përgjigje DV ASHK Tirana Rurale 1, ku citohet së nga kërkimi në sistemin dixhital gjendet kopje AMTP-ja në emër të N. K, Fshati Çekrezë, Njësia Administrative Zall-Herr.

Konkluzion: -Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Mungon e administruar deklarata noteriale me kufitaret bashkëlidhur planrilevimit të përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr,

-Plan rilevimi përgatitur nga Topografi me licencë nuk përputhet me kufitaret e shënuar në AMTP për pasurinë me nr.418 me sipërfaqe 2400 m²

14. Praktika e kryefamiljarit F. L

Me shkresën nr. 853 prot., datë 28.04.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.148 akti, datë 10.10.1996, për z. F. L drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje është e administruar:

Relacioni shpjegues të datës 20.02.2021, i përgatitur nga i konceptuar nga Z. F. L, sqaron se F. L ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën nr.,1, ju sqarojmë se:

Parcela 1 me emërtimin popullor “Mbi gropë rosë” me sipërfaqe të përgjithshme 7100 m² e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurive nr.343 me sipërfaqe 7100 m².

Plan rilevimi datë 04.02.2012 si dhe Relacioni shpjegues i datës 20.02.2021, është përgatitur nga Z. F. L që është edhe personi përfitues i Parcela 1 me emërtimin popullor “Mbi gropë rosë” me sipërfaqe të përgjithshme 7100 m², ky plan rilevimi është miratuar nga Kryetari i Fshatit Çerkezë S. K dhe nga Administratori A. M.

Konkluzion: -Mungon shkresa nga DV ASHK Tirana Rurale 1, nëse Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) në emër të z. F. L ndodhet e arkivuar apo jo.

-Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Mungon njoftimi publik i afishuar nga DV ASHK Tirana Rurale 1, për 45 ditë në lidhje me pasurinë nr.343 e pretenduar në bazë të AMTP-së, në kundërshtim me nenin 31 “Konsultimi publik” të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

-Mungon e administruar në dosje vërtetimi për shlyerjen e pagesës së tokës bujqësore.

15. Praktika e trashëgimitarit H. Q

Me shkresën nr. 897 prot., datë 06.05.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.41 akti, datë 13.03.1993, për H. Q drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje është e administruar:

-Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr, ku sqaron se, H. Q ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën nr.,1 dhe 2, ju sqarojmë se:

Parcela 1 me emërtimin popullor “Grykë” me sipërfaqe të përgjithshme 1750 m² e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurive nr.215 me sipërfaqe 1750 m².

Parcela 1 me emërtimin popullor “Shqopa” me sipërfaqe të përgjithshme 6125 m² e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurive nr. 15/3 me sipërfaqe 1875 m². pasuria nr. 17/2 me sipërfaqe 2875 m², nr. 17/4 me sipërfaqe 375 m² dhe nr.17/1 me sipërfaqe 1000 m².

Konkluzion: -Mungon shkresa nga DV ASHK Tirana Rurale 1, nëse Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) në emër të H. Q ndodhet e arkivuar apo jo.

-Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Mungon e administruar deklarata noteriale me kufitare bashkëlidhur planrilevimit të përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr.

16. Praktika e kryefamiljarit G. L

Me shkresën nr.2607 prot., datë 11.11.2020 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.113 akti datë 18.3.1996, Fshati Dritas, për **Z. G. L**, drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, bashkëlidhur janë dërguar këto dokumenta:

-AMTP-në origjinale.

-Plan rilevimi 2 (dy).

-Certifikata e gjendjes familjare me datë 07.10,1992.

-Relacionshpjegues.

Në relacionin shpjegues të datës 11.11.2020 ,i përgatitur nga i konceptuar nga Z. F. L, sqaron se, G. L, ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të Ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelat sqarojmë se:

Parcela me emërtimin popullor “Blloku të Xhajt” me sipërfaqe të përgjithshme 7800 m² e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr. 665 dhe parcela me emërtimin popullorë “Gryka e Kallmetit” me sipërfaqe 2000 m² e cila sipas HTR me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.174/9.

Nga verifikimi i bërë në librin e ngastrës për Fshatin Dritas dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor “Blloku të Xhajt” me sipërfaqe të përgjithshme 7800 m²rezultoi se pasuria “mëmë” me nr.665 është në zërin kadastral “P.F”, çfarë do të thotë se kjo ngastrë nuk ka qenë objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

“Akti i marrjes së tokës në pronësi” është i vlefshëm vetëm kur ai është krijuar sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 “Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore” i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992

Kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë private mbi tokën, të krijuar te:

a) sipërfaqet, që më 1.8.1991 kanë figuruar në regjistrat kadastrale, në zërin “Tokë bujqësore” dhe janë përfshirë në territoret e administruara nga ish-kooperativat bujqësore deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar;

Në këto kushterelacionin shpjegues të datës 11.11.2020 i përgatitur nga i konceptuar nga Z. F. L nuk qëndron për sa kohë nuk ka sqaruar se çfarë zëri kadastral është pasuria e kërkuar për regjistrim si dhe nuk është bërë verifikimi në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor “Blloku të Xhajt”.

Konkluzion: -Nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa e Z. G. L për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së me nr.Akti nr.113 akti datë 18.3.1996) pa verifikuar ngastrën me emërtimin popullor “Blloku të Xhajt” me sipërfaqe7800 m²në llojin e

pasurisë “Arë”, si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës, për të provuar vërtetësinë e llojit të pasurisë.

-Nga Njësia Administrative Zall-Herr është miratuar plan-rilevimi për ngastrën e renditur në rreshtin e parë të AMTP-së me nr.Akti nr.113 akti datë 18.3.1996, me emërtimin popullor “Blloku të Xhajt” me sipërfaqe 7800 m² duke ndryshuar llojin e pasurisë nga “P.F” në “Arë” ku me shkresën nr.2607 prot., datë 11.11.2020 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar për regjistrim pasuria me sipërfaqe 7800 m² në emër të Z. G. L.

17. Praktika e trashëgimitarit K. XH

Me shkresën nr.586 prot., datë 22.03.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në e korrigjuar nga përdorim në pronësi pa nr. Akti datë 11.7.1993, Fshati Qinam për K. XH drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje ndodhet e administruar edhe Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr ku sqaron se, K. XH ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën me numër rendor 1, ju sqarojmë se: Parcela me emërtimin popullor “Parosë 202” me sipërfaqe të përgjithshme 6000 m² për të cilën është regjistruar 1000 m² tokë dhe kërkon të regjistrohet sipërfaqja prej 5000 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurive me nr.201/ me sipërfaqe 4700 m² dhe pasuria nr. 200/ me sipërfaqe 300 m².

Konkluzion: -Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Mungon e administruar deklarata noteriale me kufitaret bashkëlidhur planrilevimit të përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr.

-Plan rilevimi përgatitur nga Topografi me licencë nuk përputhet me kufitaret e shënuar në AMTP dhe sipërfaqen përkatëse, ku pasuria me nr.201/ nuk është sipërfaqe 4700 m² por me sipërfaqe 4300 m².

18. Praktika e kryefamiljarit B. F

Me shkresën nr.631 prot., datë 20.03.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në e korrigjuar nga përdorim në pronësi pa nr. Akti datë 10.10.1993, Fshati Kallmet për B. F drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje ndodhet e administruar edhe Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr ku sqaron se, B. F ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën me numër rendor 2,3,5,6,7 ju sqarojmë se:

Parcela nr.2 me emërtimin popullor “Zalli” me sipërfaqe 1100 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.160/29 me sipërfaqe 1100 m².

Parcela nr.3 me emërtimin popullor “Mbi Zallë” me sipërfaqe 2500 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.160/30 me sipërfaqe 2500 m².

Parcela nr.5 me emërtimin popullor “Përroi i Zabelit” me sipërfaqe 10000 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.174 me sipërfaqe 10000 m².

Parcela nr.6 me emërtimin popullor “Fire” me sipërfaqe 500 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.148/1 me sipërfaqe 500 m².

Parcela nr.7 me emërtimin popullor “Qarre” me sipërfaqe 300 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.167/3 me sipërfaqe 300 m².

Konkluzion: -Mungon e administruar deklarata noteriale me kufitaret bashkëlidhur planrilevimit të përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr.

-Nuk përputhen kufitaret e pasqyruara në AMTP për parcelën nr.5 me emërtimin popullor “Përroi i Zabelit” me sipërfaqe 10000 m² ku sipas HRT me shkallë 1:2500 në veri nuk është rrugë por është me pasuri të të tretëve, ndërsa në lindje nuk është kufitar XH. F por sipas HRT është “përrua”.

19. Praktika e kryefamiljarit R. C

Me shkresën nr.632 prot., datë 30.03.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 74 akti datë 20.10.1993, Fshati Zall-Herr për R. C drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje ndodhet e administruar edhe Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr ku sqaron se, R. C ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën me numër rendor 1, ju sqarojmë se:

Parcela me emërtimin popullor “Blloku Nr.2” me sipërfaqe 2600 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.173/1 me sipërfaqe 2600 m².

Konkluzion: -Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Parcela me emërtimin popullor “Blloku Nr.2” me sipërfaqe 2600 m² në Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) nuk janë të përcaktuar kufitarët.

-Mungon e administruar deklarata noteriale me kufitaret bashkëlidhur planrilevimit të përgatitur nga Topografi me licencë i miratuar nga Njësia Administrative Zall-Herr.

20. Praktika e trashëgimtarit XH. H

Me shkresën nr.734 prot., datë 12.04.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në e korrigjuar nga përdorim në pronësi me nr. 45 akti datë 05.07.1993, Fshati Dritas për XH. H drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, në bazë të VKM-në nr.994, datë 09.12/2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP) dhe të ligjit 33/2012 datë 21/03/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”.

Në dosje ndodhet e administruar edhe Sqarimi nga Administratori i Njësia Administrative Zall-Herr ku sqaron se, XH. H ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së për parcelën me numër rendor 1, ju sqarojmë se:

Parcela me emërtimin popullor “Posht Hangari” me sipërfaqe 8000 m² e cila sipas HRT me shkallë 1:2500 i përket pasurisë me nr.384 me sipërfaqe 7050 m² dhe pasuria me nr.515/18 me sipërfaqe 375 m².

Konkluzion: -Mungon statusi juridik i pronës nga ana e DV ASHK Tirana Rurale 1, në lidhje me pasuritë që kërkohen të regjistrohen.

-Pasuria me nr.384 me sipërfaqe 7050 m² krijon mbivendosje me 384/2 dhe 384/4

-Mungon deklarata noteriale me dy pasuritë nr. 384/2 dhe 384/4 që kanë krijuar mbivendosje fiktive.
-Mungon deklarata noteriale për heqjen dorë nga sipërfaqja prej 575 m².

21. Praktika e kryefamiljarit Znj. H. K.

Me shkresën nr. 338 prot., datë 22.02.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr.119 akti datë 13.10.1996, Fshati Dritas për Znj. H. K, drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, bashkëlidhur janë dërguar këto dokumenta:

-AMTP-në origjinale.

-Plan rilevimi (dy)

Certifikata e gjendjes familjare me datë 07.10,1992.

Relacionshpjegues.

Në relacionin shpjegues të datës 01.02.2021,i përgatitur nga i konceptuar nga Z. F. K, sqaron se, H. K, banor i fshatit Dritas, Njësia Administrative Zall-Herr, subjekt i trajtimit me tokë bujqësore në bazë të Ligjit nr.7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” dhe sipas AMTP -së i cili është trajtuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokave të Fshatit Dritas, sipas AMTP-së me nr. Akti 119, me datë lëshimi 13.10,1993, me sipërfaqe të përgjithshme 13300 m² me parcelat me emërtimet popullore dhe sipërfaqet përkatëse si më poshtë:

-Parcela në AMTP me nr. Rendor 1, me emërtimin popullor “Çenge” me sipërfaqe 11000 m² e cila i korrespondon pasurive me nr. 665, me sipërfaqe 11000 m² në plan rilevimin bashkëngjitur.

-Parcela në AMTP me nr. Rendor 2, me emërtimin popullor “Parcela poshtë shtëpive” me sipërfaqe 2300 m² e cila i korrespondon pasurive me nr. 704, me sipërfaqe 2300 m² në plan rilevimin bashkëngjitur.

Nga verifikimi i bërë në librin e ngastrës për Fshatin Dritas dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor “Çenge” me sipërfaqe 11000 m²rezultoi se pasuria “mëmë” me nr. 665 është në zërin kadastral “P.F”, çfarë do të thotë së kjo ngastrë nuk ka qenë objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.

“Akti i marrjes së tokës në pronësi” është i vlefshëm vetëm kur ai është krijuar sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 255 datë 02.08.1991 “Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore” i ndryshuar me VKM nr.296, datë 07.07.1992

Kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë private mbi tokën, të krijuar te:

a) sipërfaqet, që më 1.8.1991 kanë figuruar në regjistrat kadastrale, në zërin “Tokë bujqësore” dhe janë përfshirë në territoret e administruara nga ish-kooperativat bujqësore deri në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të ndryshuar;

Në këto kushterelacionin shpjegues të datës 01.02.2020 nga i përgatitur nga i konceptuar nga Z. F. K nuk qëndron për sa kohë nuk ka sqaruar se çfarë zëri kadastral është pasuria e kërkuar për regjistrim si dhe nuk është bërë verifikimi në librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për llojin e pasurisë për ngastrën me emërtimin popullor “Çenge”.

Konkluzion: -Nga Njësia Administrative Zall-Herr, është pranuar kërkesa e Znj. H. K, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së me nr.Akti nr.119 akti datë 13.10.1993) pa verifikuar ngastrën me emërtimin popullor “Çenge” me sipërfaqe 11000 m²në llojin e pasurisë “Arë”, si dhe pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës, të fshatit Dritas për të provuar vërtetësinë ellojit të pasurisë.

-Nga Njësia Administrative Zall-Herr është miratuar plan-rilevimi për ngastrën e renditur në rreshtin e parë të AMTP-së me nr.Akti nr.119 akti datë 13.10.1993, me emërtimin popullor “Çenge” me sipërfaqe 11000 m² duke ndryshuar llojin e pasurisë nga “P.F” në “Arë”, ku me shkresën 338 prot., datë 22.02.2021 nga Njësia Administrative Zall-Herr është dërguar për regjistrim pasuria me sipërfaqe 11000 m² në emër të Znj. H. K.

Për sa është trajtuar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresënr.712/1 prot., datë 3.5.2023 dhe i administruar në KLSH me nr. 796/14, date 8,5,2023, “Mbi Projekt-Raportin e Auditimit” dërguar nga z. F. L me detyrë, specialist/topograf i ZAMIT-së, Njësia Administrative Zall-Herr, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në Projekt-Raportin e KLSH-së është përmendur emri im (F. L) për veprim dhe mos veprim për 10 rastet e përmendura në Projekt-Raportin në emër të z. S. SH,N. K, H. Q,G. L,K. XH,B. F,R. C,XH. H,H. K,K. G të cilët janë nisur jashtë afateve ligjore drejtuar DV ASHK Rurale.

“Sqaroj se nuk kemi pasur informacion në lidhje me përfundimin e afatit ligjor për nisjen e praktikave në mënyrë online. Me daljen e ligjit 20/2020 Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë sipas Nenit 5, Autoriteti përgjegjës për realizimin e proceseve kalimtare është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i audituar, pranohet fakti se nuk kemi pasur informacion për daljen e ligjit. Mos njohja dhe mos informimi për daljen e ligjit apo akteve nënligjore, nuk përbën shkak për përjashtimin nga përgjegjësia administrative apo disiplinore të nëpunësit civil, veç rasteve kur mosnjohja është objektiviisht e paevitueshme. Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë.**

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me subjektin S. SH, subjektin N. K, subjektin K. XH, subjektin R. C, mbi trashëgimtarët e familje së z.H. Q, në lidhje me Trashëg. e familjes së z.XH. H, subjektin H. K është nisur dokumentacioni pa konfirmim të statusit juridik. Për këtë rast shpjegojmë se konfirmimi i statusit juridik është nxjerrë nga printimi III i fshatit Priskë e Vogël, fshatit Cerkezë dhe fshatit Qinaqm dhe Dritase cila ka përcaktuar të dhënat e kartelave të pasurisë dhe nuk kishte përse të kërkohet konfirmimi tjetër për statusin juridik në lidhje me këto pasuri.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i audituar, sqarojmë se statusi juridik nuk zëvendësohet me printimin III i fshatit Priskë e Vogël, Cerkezë, Qinaqm dhe Dritas. Printim III ka shërbyer për dorëzimin pranë ish-ZVRPPTiranë për hapjen e kartelave të pasurive të paluajtshme sipas afishimeve të bëra pran ish-Komunës për periudhën 45-ditor.

Statusi juridik kërkohet për të konfirmuar gjendjen juridike aktuale të pasurisë, llojin e pasurisë, sipërfaqen dhe nëse pasuria është e regjistruar në emër “shtet” apo në “të tretë” dhe nuk mund të zëvendësohet me printimin III të përgatitur nga zyra e menaxhimit të projektit në vitin 2001, kur ka përfunduar edhe regjistrimi fillestar i zonave kadastrale të këtyre fshatrave.

Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë.**

Pretendim i subjektit:

Për të gjitha planet e rilevimit që nuk janë përgatitur sipas VKM-së Nr.782 datë 07.10.2020 shpjegojmë se pas dërgimit të praktikave të subjekteve të lartpërmendura janë përgatitur planet e rilevimit të reja sipas kësaj VKM dhe i janë dhënë çdo subjekti të lartpërmendur.

Qëndrimi i Grupit të auditimit

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i audituar, pranohet fakti se plan rilevimit e reja janë përgatitur bazuar në VKM-në e sipërcituar dhe i janë dhënë çdo subjekti të lartpërmendur.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste, pasuritë e përfitur me anë të AMTP-së bie mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme dhe mbi pasuri “pyll”), çfarë do të thotë se nga Njësia Administrative Zall-Herr është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Herr, hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës para vitit 1991, në lidhje me pranimin e kërkesës të znj. H. K, të z. G. L të z. H. S, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr, të verifikoj AMTP-në, ku sipërfaqja e tokës që kalohet për regjistrim, duhet të përmbushë, njëkohësisht, t'i përkasë një

prej zërave të tokës bujqësore, me qëllim konsolidimin e marrëdhënieve juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Gjithashtu, para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimit për regjistrim, duhet që specialisti i ZAMIT-së të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 para vitit 1991, për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet, planet e rilevimit të përcjella nga Njësia Administrative Zall-Herr për në DV ASHK Tirana Rurale 1, janë përgatitur dhe hartuar nga specialist/topograf i ZAMIT-së i Njesisë Administrative Zall-Herr dhe jo nga topografi i licencuar, duke mos përmbushur standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH”, në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 “Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale” *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Zall-Herr të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:Në 3 raste, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës, duke tejkalar normën për frymë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”,-me ligjin nr. 20/2020 dhe ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën” *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Zall-Herr në të gjitha rastet para se të përcjellë dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:Në 5 raste, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit të përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit nuk ka saktësuar pasurinë sipas terrenit, por i është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Specialisti i ZMMT-së, pranëNjesisë Administrative Zall-Herr në të gjitha rastet kur ka kërkesa për saktësim harte duhet ta verifikoj vetë fizikisht bashkë me topografin me licencë ndryshimet e ndodhura, pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi:Në 10 raste, dosjet e kthyer për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshëm Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë nuk janë plotësuar por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Zall-Herr, në kundërshtim me VKM nr.

994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Në gjitha rastet, dosjet e kthyer për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit nga Drejtoria e Përgjithshëm Juridike, Sektorin e AMTP-së Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Zall-Herr, duhet t’i plotësoj mangësitë e konstatuara dhe t’i ridërgojë në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga specialistit të ZAMIT-t të Njesisë Administrative Zall-Herr janë pranuar në 3 raste deklaratat e kufitarëve të miratuar vetëm nga Kryetari i Fshatit Priskë e Vogël dhe jo para noterit publik, çfarë e bëjnë këto deklarata absolutisht të pavlefshme, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Zall-Herr në të gjitha rastet kur nga personi posedues të tokës bujqësore kërkohet saktësim apo korigjim pasurie, deklaratat e kufitarëve duhet të konfirmohen para Noterit Publik.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet, mbas vitit 2020, edhe pse ligji për procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka ndryshuar, nga Njësia Administrative Zall-Herr janë dërguar dokumentacionet për regjistrim, ku si bazë ligjore i referohet Ligjit dhe VKM-ve të shfuqizuar, çfarë do të thotë një papërgjegjshmëri nga ana e nëpunësve të administratës, ku njohja me ndryshimet ligjore dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve duhet të jetë një element kyç për rritjen e përgjegjshmërisë të administratës të Njesisë Administrative Zall-Herr, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” (*Më hollësisht janë trajtuar në faqen 6-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Njësia Administrative Zall-Herr, të dërgoj praktikat për regjistrim në DV ASHK Tirana Rurale, në mbështetje të **Ligjit nr. 111/2018** “Për Kadastrën” ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë dhe VKM-vë që janë në fuqi.

Në vijimësi

B. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi (Tematik).

AUDITUESIT SHETETORË TË KLSH

K. GJ

S. S

P. GJ

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

B. D

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT